



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:278818  
Datë: 13.12.2021  
Numri i dokumentit: 02502365

**PA1.nr.973/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarës H. D., nga S....., për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumenteve, nga neni 398, par.2, lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), për të vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.85/2020, datë 31.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.12.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.85/2020, datë 31.05.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.85/2020, datë 31.05.2021, të akuzuarën H. D., e ka shpallur fajtores për shkak për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumenteve, nga neni 398 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe të njëjtën për shkak të kësaj vepre penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura brenda kohës së verifikimit prej dy (2) viteve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale. Është obliguar e akuzuara që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00

€ (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 69 par. 1 të KPRK-së, krahas dënimit kryesor i ka shqiptuar dhe dënimin plotësues- marrja e sendit, me të cilin e ka urdhëruar konfiskimin i përhershëm i certifikatës nr. L4/2175 të datës 20.04.2016 dhe vërtetimi nr. \*\*\*\*\*/2018 të datës 29.03.2018 i Zyrës për çështje të kategorive të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sipas aktakuzës palë e të dëmtuarës nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore- juridike, gjykata nuk vendosi fare në procedurë penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, për shkak të vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarës t'i shqiptohet dënim më i ashpër.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtrësën PPA/II.nr.990/2021, datë 30.07.2021, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurori i Prokurorisë Themelore, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarës të i shqiptohet një dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka marrë si rrethana lehtësuese ku ka marrë parasysh se e njëjta e ka pranuar fajësinë lidhur me akuzën e cila i vihet në barrë me çka në masë të madhe i ka ndihmuar gjykatës përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike, rrethanat e saja personale, se është e martuar, nënë e tre fëmijëve, pendimin e saj për veprën penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë shkallën e lartë të dashjes së të akuzuarës dhe faktin se kryerja e veprave penale të kësaj natyre është në rritje se sipër. Tutje në ankesë prokurori thekson

se gjykata e shkallës së parë gjatë matjes së dënimit i ka marrë mbivlerësuar rëndësinë e rrethanave lehtësuese sepse në shkresat e lëndës kanë ekzistuar të gjitha provat materiale se e akuzuara e ka kryer veprën penale të lartcekur.

Gjykata e Apelit e Kosovës , vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit për një dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 dhe 74 të KPRK, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç'rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarën ka marrë faktin se e njëjta gjatë shqyrtimit gjyqësor e pranoi e fajësinë në tërësi me të cilën i ndihmoi në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike si dhe si rrethanë lehtësuese nga e akuzuara, ka shprehur keqardhje për veprën e kryer se është penduar për veprën e kryer, faktin se është person familjar, nënë e tre (3) fëmijëve, pastaj pendimin e saj të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, si dhe premtimin se nuk do të përsërisë vepra të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë shkallën e lartë të dashjes së të pandehurës si dhe faktin se kryerja e veprave penale të kësaj natyre është prezentë në vendin tonë. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e prokurorit në ankesë për një dënim më të ashpër nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarës t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës si ekzekutore dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësit do ta parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij, kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
PA1.nr.973/21, më datë 08.12.2021

**Zyrtarja ligjore,**  
Rrezarta Bala

**Anëtarët e kolegjit:**  
Ferit Osmani

**Kryetar i kolegjit,**  
Hashim Çollaku

Zyhdi Haziri